



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:018900

Datë: 27.05.2019

Numri i dokumentit: 00328702

PKR.nr. 247/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE –Departamenti për Krime te Rënda ne Trupin Gjykuese te përberë nga Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykues, dhe gjyqtarëve Myfera Hoxha dhe Gëzim Pozhegu, anëtar të Trupit Gjykues, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarave B. I nga fshati . K-Gjakovë, të akuzuarit S.K. nga fshati .. K-Vushtri, për shkak të veprës penale kontrabandim me migrantë nga neni 164 prg 1 KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzën Prokurorisë se Qarkut ne Peje tani Prokuroria Themelore-Departamenti për Krime te Rënda në Gjakovë PP.nr.123/2008 datë 16.06.2008, në shqyrtimin gjyqësorë publik të mbajtur më datën 21.05.2019, me pjesëmarrjen e Prokurorit te Shtetit te PTH ne Gjakovë Ali Uka , të akuzuarit S. K. se bashku me mbrojtësin e tij av. A. M., të njëjtën ditë publikisht shpalli ndërsa me dt. **23.05.2019** përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari : S.K. data e lindjes... ne fshatin .ilanc K-Vushtri, tani me banim të përkohshëm në Belgjike R.S. N. Belgjik, nga i ati A. dhe ëma Sh. e lindura Sh., i martuar, i ati i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën mesme, me profesion punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës, ndaj të cilit nuk ndiqet procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Me dt. 16.02.2008, në Gjakovë, me qellim të përfitimit të dobisë pasurore kanë marrë pjesë në kontrabandë me migrantë përkatësisht me kon trandim të dëmtuarit A. H. nga

fshati .. K-Rahovec, në atë mënyrë që ditën kritike të pandehurit janë takuar më të dëmtuarin dhe vëllain e tij – dëshmitarin A.H., në lokalitetin e quajtur “ ...”, në Gjakovë, të njëjtit janë marrë vesh që për sasinë e të hollave prej 2.800(dy mijë e tetëqind)€, ta dërgojnë të dëmtuarin A. H., për në shtetin e Italisë, me q rast i dëmtuari për mes mikut të tij Rr. G. , ja ka paguar shumën prej 400(katërqind)€, dhe atë në monedhe prej 50(pesëdhjetë)€, si dhe një telefon mobil, në vlerë prej 400(katërqind)€, krejt këtë më qëllim që i dëmtuari të shkojë për në Itali, ku dhe i njëjti është nisur por është ndaluar dhe kapur nga ana e policisë Boshnjake, në qytetin e Velika Kladusha të Bosnjës.

- me çka kishin për të kryer veprën penale kontrabandim me migrantë nga neni 164 par. 1 të KPRK-së.

Andaj trupi Gjykuësor në bazë të dispozitave të nenëve 3, 4, 7, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 69, 70, dhe 72 dhe neni 164 prg 1 të KPRK-se, si dhe nënti 365, të KPPK-se, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMI ME KUSHT DHE GJOBE

I shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që e i akuzuari në afat prej 2 (dy) vite nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, nëse vjen deri të revokimi i dënimit me kushte, në këtë dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt. 23.09.2013, gjere me dt. 26.04.2013, si dhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 23.04.2019, gjere me dt. 21.05.2019, si dhe dënimin me gjobe në shumë prej 500 (pese qind)€, të cilin dënim i akuzuari obligohet që të paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, po që se i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar i njëjti dënim i zëvendësohet me dënim burgimi prej 25 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg shumën me nga 20€.

I dëmtuari A. H. nga fshati ... K- Rahovec, tani me banim në Prizren rruga “ N.T. “ nr. ..., udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50(pese dhjete)€, si dhe në emër të fondit të viktimave shumën prej 50 (pese dhjete)€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut në Pejë, ka ngritur aktakuzën PP/ nr. 123/08 dt. 16.06.2008 kundër të akuzuarave B. I nga fshati ..K-Gjakovë dhe S. K. nga fshati ... K-Vushtri, për shkak të veprës penale kontrabandë me emigrante nga neni 138 par 1, si bashkë kryes lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

Gjykata Themelore në Gjakovë, me aktgjykimin P.nr. 297/2008 PE-1, të dt. 26.04.2013, të akuzuarit B. I. dhe S.K. , komform nënti 364 prg 1 të KPPK-se, i ka liruar nga akuza për shkak veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 138 prg 1 si bashkë kryes lidhur me nenin 23 të KPPK-se.

Kundër këtij aktgjykimi Prokurori i Çështjes ka parashtruar ankese andaj me aktvendimin e Gjykatës së Apelit ne Prishtinë PAKR.nr. 280 /2013, te dt. 18.11.2014, është aprovuar ankesa e Prokurorisë Themelore ne Gjakove, dhe çështja i është kthyer Gjykatës se shkalles së parë për rigjykim.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin kryesore me dt. 16.11.2017, ku ka prezantuar përfaqësuesi i akuzës ndërsa të akuzuarit B. . dhe S. K. nuk kane prezantuar ne Gjykatë dhe te njëjtit nuk kane njoftuar Gjykata për ndërrimin e adresave te banimit andaj ndaj te njëjtëve Gjykata ka lëshuar urdhër arrest dhe letër rreshtim vendor.

Me dt. 24.04.2019, i akuzuari S. K. është ndalur ne ajroportin e Prishtinë dhe është sjellur ne Gjykate sipas flete rreshtimit vendore dhe ndaj te njëjti Gjykata ka caktuar masën e paraburgimit, dhe është caktuar seanca e shqyrtimit kryesore me dt. 21.05.2019, ku ka prezantuar Prokurori i shtetit Ali Uka, i akuzuari S.K. se bashku me mbrojtësin e tij av. A. M., ndërsa nuk ka prezantuar i akuzuari B. I. për te cilin është konstatuar se i njëjti është ne vuajtje te dënimit me burg ne shtetin e Gjermani, dhe me propozim te Prokurorit është veçuar procedura penale ndaj te njëjtit.

Prokurori i Shtetit para leximit te aktakuzës ka bërë ricilsimin juridik te veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 138 prg 1 te KPK-se, ne vepër penale kontrabandim me migrant nga neni 164 prg 1 te KPRK-se, pasi qe i njëjti ligj është me i favorshme për te pandehurin komform nënti 3 te KPRK-se.

Pas leximit te aktakuzës ne seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata është e bindur se i akuzuari ka kuptuar aktakuzën dhe është dhënë mundësia qe te deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar te akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit te fajësisë ne kuptim te nenit 326 te KPRK-se, kështu qe pas konsultimeve te bëra me mbrojtësin e tij i njëjti ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit te fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje e vullnetit te tij te lire pasi qe është kryes i kësaj vepre penale për te cilën akuzohet dhe i ka propozuar Gjykatës qe te aprovoi pranimin e fajësisë.

Pas deklarimit te akuzuarit për pranimin e fajësisë Kryetari i trupit Gjykues kërkoi qe mendimin e vete te jep Prokurori i Shtetit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar : se këtu i akuzuari S. K. ne këtë shqyrtim gjyqësor pranon fajësinë për vepër penale nga aktakuza e te ricilesuar ne kete shqyrtim gjyqësore duke qene te bindur se ky pranim i fajësisë nga ana e tij është bere me vullnet e pa presion pranimi i fajësisë mbështet ne prova e cekura ne aktakuze e te siguruar gjate procedurës se hetimeve andaj i ka propozuar Trupit Gjykuese qe te aprovoi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i te akuzuarit S.K. av. A. M. ka deklaruar se pas konsultimeve te mjaftueshme me te mbrojturin e tij i njëjti ka vendosur qe te pranoi fajësinë i kam shpjeguar për te gjitha favoret si dhe pasojat e pranimit te fajësisë.

Trupi Gjyqese pas dëgjimit të palëve dhe mbrojtësit të akuzuarit ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë nga se ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe atë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. A. M. se pranimi i fajësisë mbështet në fakte e qeshtjes që përmban aktakuza dhe atë: shiqimin e raportit të oficerit policore të dt. 03.03.2008, raporti i përpiluar nga autoritet kufitare të Bosnes me nr, 18-13-3-13-57-07/8 si dhe nga deklarimi i të dëmtuarit A. H. si dhe dëshmitareve A. H. dhe R. G. të cilat prova janë bashkangjitur aktakuzës, andaj trupi Gjyqese ka aprovuar fajësinë e të akuzuarit.

Prokurori i shtetit Ali Uka, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: se këtu i akuzuari në këtë shqyrtim kryesore ka pranuar fajësinë për veprë penale për të cilën akuzohet dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet dhe pa presion i cili pranim i fajësisë mbështet në prova të siguruara gjatë procedurës së hetimeve e të propozuara në aktakuzës andaj i propozoi trupit Gjyqese që i njëjti të shpallet fajtorë të gjykohet sipas ligjit dhe gjatë shqiptimit të dënimit gjykata të ketë parasysh e gjitha rrethanat, sidomos rrethanat lehtësuese pranimin e fajësisë si dhe nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë e gjatë.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.K. av. A. M. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi im në fillim të shqyrtimit gjyqësorë ka pranuar fajësinë që i vihet në barrë sipas aktakuzës meqenëse nga koha e kryerjes së veprës penale gjere me sot ka kaluar afati mbi 11 vite, i njëjti gjatë kësaj periudhe nuk ka ra ndesh me Ligjin, Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit duhet të ketë parasysh këto rrethana, pranimin e fajësisë sjelljen korrekt të akuzuarit gjatë shqyrtimit kryesore gjendjen e tij ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes i ati i 4 fëmijëve, dhe me shqiptimin e dënimit të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me Ligj.

I akuzuari S.K. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e përkrah deklarimin e mbrojtësit të tij, ka shpreh keq ardhje për rastin ka kërkuar falje Gjykatës dhe ka premtuar që në të ardhmën nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Me faktet të ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, andaj në veprimet e të njëjtit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale kontrabandim me migrant nga neni 164 prg 1 të KPRK-se, për të cilën veprë penale i akuzuari është penalisht i përgjegjshëm dhe është gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, Trupi Gjyqese ka marrë për baze të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 69, 70, të KPRK-se, si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka shprehur keq ardhje është mbajtës i vetëm i familjes i ati i katër fëmijëve, është pënduar për veprën e kryer andaj Gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar pasi që nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar afati mbi 11 vite, andaj edhe me këtë dënim të kushtëzuar edhe dënim më gjobe dot e arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston parandalimin nga kryerja e vepra penale në të ardhmen dhe të behet rehabilitimit i tij të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale të shpreh gjykimin shoqërorë për veprë penale ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektim të Ligjit.

Vendimi mbi udhëzimin e te dëmtuarit që kërkesën pasurore juridike të realizoi në kontest të rregullt civil Gjykata e bazoi në nenin 463 prg 2 të KPPK-se.

Lidhur me shpenzimet e paushallit gjyqësor është vendosur komform nënti 450 të KPPK-se, ndërsa lidhur me taksat për kompozimin e viktimave të krimit është vendosur në baze të nënti 39 prg 3 nën prg 3.2 të Ligjit për kompozimin e viktimave të krimit.

Nga se u tha me lartë komform nënti 365 prg 1 të KPPK-se, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË ,–Departamenti për Krime të Renda

PKR.nr. 247/2014, te dt. 23.05.2019,

**Procesmbajtësja
Bute Ramosaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Shaqir Zika**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afatë prej 15 ditëve nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj Gjykata për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Numri i lëndës: 2018:018900
Datë: 27.05.2019
Numri i dokumentit: 00328702